



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	D-P
Nr. Ufaq. broj. stranica	01
Nr. Prot. Prot. No	03-27/19/11
Data Datum	13.05.2011



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË / OPSTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISTINI / MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 16956/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Milazim Vllasaliu nga Novo Bërda. për kundërvajtje nga neni 6 parag.2 lidhur me nenit 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, e ne bazë të nenit 73,74,195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Milazim Adil Vllasaliu i lindur më 1952 në Novo Bërdë me vendbanim në Prishtinë rr."LLapit" nr.37,i martuar baba i 2 fëmijëve,me profesion konzul në Ambasadën e Kosovës në Berlin

E s h t ë p ë r g j e g j e s e

Sepse si Zyrtar i Lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës-Konzull në Berlin,,nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor edhe pse ka qenë i përfshirë në listen e Zyrtarëve të Lartë Publik të cilët janë të obliguar të deklarojnë pasurinë. Me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje të nga nenit 6 parag.2 lidhur me nenin 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj për këtë.

G J O B I T E T

Me gjobë ne shumë prej 1000(njëmijë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që i aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. Nr.1000 4300 7000 0518. Paga bërë në ndonjë agjensi për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpaguesës të plotësuar nga Gjykata.Nese gjobën e shqiptuar nuk e paguan ne afatin e dhenë e njëjta do ti zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse ne emër të paushallit gjyqsor e pandehura është e obliguar të paguaj shumën prej 5 €, në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë parashtror gjykatës kërkesën nr.01/2282/2010 më dt.15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Milazim Vllasaliu dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në seancën gjyqësore të caktuar për date 14.07.2010,i pandehuri Milazim Vllasaliu në mbrojtjen e vet e pranoi kundërvajtjen e cila i vëhet në barrë që don të thotë se nuk e ka dërguar me kohë formularin mbi deklarin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit duke u arsyetuar se shërbimi kompetent i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës,nuk ua ka dërguar me kohë për ti plotësuar.

Nga të dhënat e parashtruara në kërkesë deklarata e të pandehurit si dhe nga shiqimi dhe vlerësimi I shkresave tjera të deponuara në lëndë,Gjykata konstatoi se I njëjti e ka kryer kundërvajtjen ashtu siq e rëndon kërkesa,për çka u shpall i fajshëm dhe në vështrim të nenit 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik,u gjobit me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës se marrjes së ketij aktvendimi nepërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

Me dt. 03.03.2011

KRYETARI I GJYKATËS

Mustafë Selimi